



Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2026

Shtojca 14.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Data 31/03/2026**Drejtuar:****Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X**

“AL-BASALT SHPK”, me Nuis K67812301C dhe me adrese Autostrada Skuraj-Milot, km 1, Ndertese 1 kateshe, Zona Kadastrale nr. 3470, me Pasuri nr.284, Skuraj, Milot, Lezhe & “BAMI HOLDING” Shpk, me Nuis J94416206R, me adrese Rruga Kameronas, Fushe Kruje, Durres.

OE “AL-BASALT SHPK”, me pjesemarrje prej 3.03 %

OE “BAMI HOLDING” Shpk, me pjesemarrje prej 96.97 %

- OE/BOE me nënkontraktorPO JO **-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**PO JO **Drejtuar:****Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X**

“ALMO KONSTRUKSION”, me Nuis J91915001P dhe me adrese Lagjia Zall - Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054, Kamez, Tirane & “VASHTEMIA” Shpk, me Nuis J64103054Q dhe me adrese Rruga Nacionale Korçe-Pogradec, Km i 7, 500 m, majtas rruges nacionale, zona kadastrale nr.3716, nr.pasurie 686/5, 686/6, Vashtemi, Libonik, Korçe.

OE “ALMO KONSTRUKSION” Shpk, me pjesemarrje prej 83.28 %

OE “VASHTEMIA” Shpk, me pjesemarrje prej 16.72 %

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Drejtuar:

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

“PEPA GROUP” Shpk, me Nuis L42215009L dhe me adrese Autostrada Tirane-Durres km 6, Zona Kadastrale nr. 2105, Nr. Pasurie 1168/13, Kashar, Tirane & “EUROTEOREMA PEQIN” Shpk, me Nuis J61905050M dhe me adrese Kryqezimi i Rruges 5 Maji, me Rrugen Selaudin Bekteshi, Njesia Administrative nr. 4, Godina ETG, 1017, Tirane.

OE “PEPA GROUP” Shpk, me pjesemarrje prej 81.1 %

OE “EUROTEOREMA PEQIN” Shpk, me pjesemarrje prej 18.9 %

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

* * *

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur, mbi kufirin e larte monetar.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Loti I-re: REF-75572-02-09-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale te Fshatrave ne Njesite Administrative te Bashkise Lezhe”, Loti I-re: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Zejmen, Shengjin dhe Kolsh”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes Kuader.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 10/02/2026.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 14, datë 16 Shkurt 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “AL-BASALT SHPK”, me Nuis K67812301C & “BAMI HOLDING” Shpk, me Nuis J94416206R dhe me oferte ekonomike 332,794,258.96 (treqind e tridhjetë e tre milion e shtatëqind e nentëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë pike nentëdhjetë e gjashtë) Lek pa Tvsh,

OE “AL-BASALT SHPK”, me pjesëmarrje prej 3.03 %

OE “BAMI HOLDING” Shpk, me pjesëmarrje prej 96.97 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

- 2- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “ALMO KONSTRUKSION”, me Nuis J91915001P & “VASHTEMIA” Shpk, me Nuis J64103054Q dhe me oferte ekonomike 348,506,807 (treqind e dyzet e tetë milion e pesëqind e gjashtë mijë e tetëqind e shtatë) Lek pa Tvsh,

OE “ALMO KONSTRUKSION” Shpk, me pjesëmarrje prej 83.28 %

OE “VASHTEMIA” Shpk, me pjesëmarrje prej 16.72 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

- 3- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “K.M.K” Shpk, me Nuis L78223801E & “Caushi M”, me Nuis L88419801O dhe me oferte ekonomike 241,063,207 (dyqind e dyzet e një milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatë) Lek pa Tvsh,

OE “K.M.K” Shpk, me pjesëmarrje prej 81.1 %

OE “Caushi M” Shpk, me pjesëmarrje prej 18.9 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

- 4- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PEPA GROUP” Shpk, me Nuis L42215009L & “EUROTEOREMA PEQIN” Shpk, me Nuis J61905050M dhe me oferte ekonomike 308,613,764.36 (treqind e tetë milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër pike tridhjetë e gjashtë) Lek pa Tvsh,

OE “PEPA GROUP” Shpk, me pjesëmarrje prej 81.1 %

OE “EUROTEOREMA PEQIN” Shpk, me pjesëmarrje prej 18.9 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “K.M.K” Shpk, me Nuis L78223801E & “Caushi M” Shpk, me Nuis L88419801O,

OE “K.M.K” Shpk, me pjesemarrje prej 81.1 %

OE “Caushi M” Shpk, me pjesemarrje prej 18.9 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga Bashkimi i Operatori Ekonomik rezulton se:

Se pari, Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se oferta ekonomike e paraqitur nga BOE “K.M.K” Shpk & “Caushi M” Shpk eshte anomalisht e ulet, pasi eshte më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme te paraqitur ne kete procedure prokurimi.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave krahasoi vlerat e ofertave te vlefshme me vleren e 85% te mesatares se tyre, ku rezultoi se nga krahasimi i ketyre ofertave vetem oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “K.M.K” Shpk & “Caushi M” Shpk eshte ne vleren e **78% e mesatares se ofertave** e per rrjedhoje **eshte anomalisht e ulet dhe duhet refuzuar pa kerkuar shpjegime** bazuar kjo ne nenin 27, te ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, si dhe nenin 82/4, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Per sa me siper, Komisioni i Vleresimit te Ofertave vlereson se oferta e paraqitur nga BOE duhet refuzuar pa shpjegime, kjo bazuar ne ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, ne nenin 27, ku percaktohet se: *“Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”, si dhe nenin 82/4, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.5 te DST-se ku parashikohet se: *“Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeometer/Topograf	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Betonues	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Karpentier	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Punonjes per punime ne Rruge dhe Asfaltim 6 (gjashte)		Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Shofer	7 (shtate)	Leje Drejtimi
- Manovrator	7 (shtate)	Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi te Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Tetor 2025 – Dhjetor 2025.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cila duhet te dorëzohet ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.4 te DST-se.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, vërehet se Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë në deklarinë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit ka deklaruar se disponon shofertat dhe manovratorët me kontratë pune për objektin e tenderuar (‘Loti I-re: “Sistemi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale në Njësitë Administrative Zejmen, Shengjin dhe Kolsh”), lidhur me datë 12.03.2026 (data e hapjes së ofertës), ku rrjedhimisht këto punonjës nuk figurojnë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Tetor 2025 – Dhjetor 2025.

Sa më sipër duke qenë se BOE nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit diponimin e stafit mbështetës shofer dhe manovrator për periudhën Tetor 2025 – Dhjetor 2025, ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Se treti, nuk plotëson kriterin 2.3.8 të DST-së ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:*

- Licence e leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Licencën e leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Nga verifikimi në SPE rezulton se ky BOE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon se ndonjë nga anëtarët e BOE-së janë të pajisur me Licencën të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Po ashtu, nga verifikimi në QKB rezulton asnjë nga anëtarët e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë nuk është i pajisur me Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Sa më sipër, duke qenë se asnjë nga anëtarët e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë nuk është i pajisur me Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B **“Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”**, ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Se katërti, nuk plotëson kriterin 2.3.10/2 të DST-së ku parashikohet se: **“2.3.10/2 Per Hekur:**

- Kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.

Nga analizimi i Dokumentave standarte të tenderit vërehet se për vendosjen e këtij kriteri Autoriteti Kontraktor është bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rendesise së vecante të objektit të prokurimit duke vlerësuar si të nevojshme që mallrat që do të perdoren në realizimin e punimeve të furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar, kjo në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për

prokurimin publik” dhe ne nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper dhe pas shqyrtimit te kriterit dhe qellimit te vendosjes se tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri OE-te ne rast se ***nuk jane prodhues*** duhet te paraqesin per “***Hekurin***”, ***kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar***.

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin per secilin nga materialet e kerkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se per “***Hekurin***”, BOE ka paraqitur kontrate furnizimi me operator (furnizues) i cili nuk eshte prodhues.

Po ashtu, nga verifikimi ne faqen zyrtare te QKB-se www.qkb.gov.al, rezulton se subjekti me te cilin ka lidhur kontrate furnizimi nuk disponon leje mjedisore si prodhues, kjo detyrim ligjor per te gjithë subjektet prodhuese ne Republikën e Shqiperise.

Sa me siper, duke qene se furnizuesi i paraqitur nga BOE per materialet e mesiperme nuk eshte prodhues, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e **BOE “K.M.K” Shpk, me Nuis L78223801E & “Caushi M”, me Nuis L88419801O**, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “K.M.K” Shpk, me Nuis L78223801E & “Caushi M”, me Nuis L88419801O, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PEPA GROUP” Shpk, me Nuis L42215009L & “EUROTEOREMA PEQIN” Shpk, me Nuis J61905050M dhe me oferte ekonomike 308,613,764.36 (treqind e tete milion e gjashtëqind e trembedhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër pike tridhjetë e gjashtë) Lek pa Tvsh,

OE “PEPA GROUP” Shpk, me pjesëmarrje prej 81.1 %

OE “EUROTEOREMA PEQIN” Shpk, me pjesëmarrje prej 18.9 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

- 2- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “AL-BASALT SHPK”, me Nuis K67812301C & “BAMI HOLDING” Shpk, me Nuis J94416206R dhe me oferte ekonomike 332,794,258.96 (treqind e tridhjetë e tre milion e shtatëqind e nentëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e tete pike nentëdhjetë e gjashtë) Lek pa Tvsh,

OE “AL-BASALT SHPK”, me pjesëmarrje prej 3.03 %

OE “BAMI HOLDING” Shpk, me pjesëmarrje prej 96.97 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

- 3- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “ALMO KONSTRUKSION”, me Nuis J91915001P & “VASHTEMIJA” Shpk, me Nuis J64103054Q dhe me oferte ekonomike 348,506,807 (treqind e dyzet e tete milion e pesëqind e gjashtë mijë e teteqind e shtatë) Lek pa Tvsh,

OE “ALMO KONSTRUKSION” Shpk, me pjesëmarrje prej 83.28 %

OE “VASHTEMIA” Shpk, me pjesemarrje prej 16.72 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO

JO X

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.